REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 348, Datë 12.11.2026

MBI

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 287, DATË 13.11.2025 "MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "INFOTELECOM - ALBSOLAR 4" SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 59/2026 "*Për sektorin e energjisë elektrik*e"; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*"; si dhe nenit 15 të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.11.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 3191/4 prot., datë 11.11.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës *"Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 287, datë 13.11.2025"Mbi licencimin e shoqërisë "Infotelecom-Albsolar 4" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike"*,

Konstatoi se:

1. **Të dhëna mbi shoqërinë "Infotelecom-Albsolar 4" sh.p.k.**

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 287, datë 13.11.2025 vendosi të licencojë shoqërinë "Infotelecom-Albsolar 4" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet prodhues 35.6 MW, me vendndodhje në rrugën "Gjorica e Poshtme", Njësia Administrative Gjoricë, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër, për një afat 30-vjeçar.
- Në pikën 2 të këtij vendimi përcaktohet se "*Brenda datës 01.10.2026, shoqëria duhet të raportojë në ERE në lidhje me nënshkrimin e Marrëveshjes Përfundimtare me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike".*

2. **Analiza ligjore dhe vlerësimi**

- Në kushtet kur shoqëria nuk kishte depozituar informacion apo dokumentacion lidhur me përmbushjen e detyrave të përcaktuara në vendimin e bordit të ERE-s nr. 287, datë 13.11.2025, u vlerësua zhvillimi i një seance dëgjimore për sqarimin e shkaqeve të mosdepozitimit dhe të statusit të përmbushjes së këtyre detyrave, për të cilën me shkresën nr. 3191/1 prot., datë 27.10.2026, ERE ka njoftuar shoqërinë.
- Seanca dëgjimore u zhvillua në mjediset e ERE-s, në datën 03.11.2026, gjatë së cilës shoqëria sqaroi se mosdepozitimi në kohë i dokumentacionit kishte ardhur si pasojë e pritjes për nënshkrimin e marrëveshjes përfundimtare, me qëllim depozitimin e saj pranë ERE-s së bashku me dokumentacionin përkatës, ndaj kërkoi mundësinë për të plotësuar dokumentacionin e munguar dhe marrjen në konsideratë të sqarimeve dhe dokumentacionit të paraqitur gjatë seancës dëgjimore, si dhe të atij të depozituar në vijim.
- Me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 3191/2 prot., datë 03.11.2026 dhe nr. 3192/3 prot., datë 05.11.2026, shoqëria ka depozituar Marrëveshjen përfundimtare të nënshkruar me MIE-n, "*Lidhur me projektimin, financimin, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e një centrali fotovoltaik me kapacitet minimal të instaluar 10 MW dhe kapacitet të mbështetur deri në 100 MW, që do të jetë në Gjoricë e Poshtme, Bashkia Bulqizë, Shqipëri",* me nr. 8914/1 prot. datë

03.11.2026, në të cilën përcaktohet se kushtet përkatëse të Marrëveshjes së Zhvillimit, datë 04.12.2024, janë përmbushur.

- Në pikën 1.7 të kësaj marrëveshjeje përcaktohet se: *në zbatim të pikës 2.9 të Marrëveshjes për Zhvillimin e Projektit, data e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje përfundimtare është data e hyrjes në fuqi të marrëveshjes për zhvillimin e projektit.*
- Referuar nenit 1 të Marrëveshjes së Zhvillimit, *afati i synuar i operimit tregtar është 24 muaj nga data e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes Përfundimtare*, që, sipas datës së marrë në konsideratë në dokumentacionin e paraqitur, përkon me datën 03.11.2028. Shoqëria ka kërkuar në shkresën e saj që, në kuadër të fillimit të operimit, të merren në konsideratë sa përcaktuar në marrëveshje.
- Për sa më sipër, vlerësohet se me depozitimin e marrëveshjes përfundimtare shoqëria ka plotësuar pjesërisht pikën 2 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 287/2025. Për këtë arsye pika 2 duhet të ndryshojë dhe të bëhet: "*Shoqëria "Infotelecom-Albsolar 4" sh.p.k. duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike jo më vonë se data 03.11.2028".*

3. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Në nenin 113 të ligjit nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*", është parashikuar se një akt administrativ mund të ndryshohet nga organi publik që ka kompetencë për ta nxjerrë atë. Në kushtet kur kanë ndryshuar rrethanat dhe shoqëria ka depozituar Marrëveshjen Përfundimtare me MIE-n, si dhe duke marrë në konsideratë afatin e synuar për fillimin e operimit tregtar të përcaktuar në këtë marrëveshje, vlerësohet e nevojshme ndryshimi i pikës 2 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 287/2025.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e një ndryshimi në vendimin e bordit të ERE-s nr. 287, datë 13.11.2025, si vijon:
   a) Pika 2 ndryshon dhe bëhet:
   2. Shoqëria "Infotelecom-Albsolar 4" sh.p.k. duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike jo më vonë se data 03.11.2028.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë "Infotelecom-Albsolar 4" sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqërinë "Operatori i Sistemit të Transmetimit" sh.a., shoqërinë "Furnizuesi i Tregut të Lirë" sh.a. dhe shoqërinë "Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike" (ALPEX) sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe në përputhje me legjislacionin në fuqi.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI